

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NDERMARRJA PUBLIKE LOKALE EKO LLAPI SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **ELL**

-26-5915-1-2-1

Sa i përket tenderit për **Furnizimi, transporti dhe montimi i inventarit për kopshte**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	WOOD CORPORATION L.L.C.
NUI	811289562
Adresa	Rr.Ukë Bytyqi
Vendi	Suharekë
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Driton Gashi
Adresa elektronike	info@tenaseri.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi, transporti dhe montimi i inventarit për kopshte

Ne parashtrëse

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ne parashtrëse

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik

- Neni 1 – Qëllimi
- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

- Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
- Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

- Neni 38 – Sqarimi i Tenderëve
- Neni 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 43 – Ndërprerja e procedurave të prokurimit
- Neni 64 – Paraqitja e ankesës dhe afatet kohore për dorëzimin e një anese në OSHP
- Neni 65 – Përmbytja Themelore e një anese të dorëzuar OSHP-së
- Neni 69 – Tarifa e anesave

Udhëzuesi Operativ nr. 001/2023

- Pika 10 – Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

1. Ankuesi Wood Corporation LLC nëpërmjet kësaj Anese e kundërshton vendimin e datës 17.09.2026 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, si dhe Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit është anuluar aktiviteti i prokurimit dhe eliminuar oferta e Ankuesit, të dyja të datës 10.09.2026. Ankesa mbështetet në të njëjtat pretendime të paraqitura në kërkesën e 14.09.2026 përkatësisht arsyetimin e pamjaftueshëm të eliminimit, dyshimet e paverifikuara për certifikatat, mungesën e kërkesës për sqarim dhe anulimin e mbështetur mbi atë eliminim. Vërejtjet për arsyet e reja të vendimit të 17.09.2026 janë përgjigje ndaj tyre, jo pretendime të pavarura.

2. Ankuesi ka interes të drejtpërdrejtë sepse ka ofertuar, është eliminuar dhe ka paraqitur kërkesën paraprake. Neni 109 i LPP-së dhe neni 64 i Rregullores mundësojnë ankesën kundër vendimit të marrë sipas nenit 108/A, brenda dhjetë ditëve nga ai vendim. Data e njoftimit dhe e parashtrimit dëshmohen nga sistemi elektronik.

3. Autoriteti kontraktues e arsyetonin eliminimin vetëm me pohimin se certifikatat e dorëzuara ‘nuk korrespondojnë me certifikatat sipas dosjes së tenderit’. Nuk tregohen certifikata dhe kërkesa përkatëse, dallimi i saktë ose pasoja materiale e tij. Ankuesi nuk

mund të kuptonte cilit kusht nuk i përgjigjej oferta. Neni 59 i LPP-së dhe neni 40 i Rregullores kërkojnë vlerësim kundrejt kriterëve të dosjes, jo një përfundim të përgjithshëm apo vlerësime mbi baza hipotetike të ofertave. Vetëm në vendimin e refuzimit AK përmend pikat 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit dhe emërton certifikata të caktuara. Arsyetimi i mëvonshëm nuk ndryshon faktin se ankuesi u eliminua mbi një njoftim që nuk i individualizonte shkaqet. Edhe vendimi i ri nuk paraqet krahasim për secilin artikull dhe për secilën dëshmi, as nuk shpjegon se çfarë është kërkuar shprehimisht dhe pse dallimi nuk mund të sqarohet.

4. Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues e ka quajtur ofertën ‘administrativisht të papërgjegjshme’, ndërkohë që Autoriteti Kontraktues e lidh kundërshtimin me përmbajtjen teknike të certifikatave. Letra përmban edhe emërtimin e pandërlidhur ‘Mirëmbajtja e kanalizimit’, kurse B58 përmend ‘Komunën e Podujevës’ si anuluese. Kërkesa për rishqyrtim identifikon NPL EKO LLAPI SH.A. si Autoritet Kontraktues, ndërsa vendimi i 17.09.2026 del në emër të Komunës së Podujevës dhe e paraqet ndërmarrjen si nismëtare ‘përmes zyrës së prokurimit’ të Komunës. Këto mospërputhje duhen sqaruar me dokumentet e prokurimit dhe autorizimin përkatës, sepse dobësojnë besueshmërinë e arsyetimit individual.

5. Në kërkesën për rishqyrtim është vënë në dukje se në B58 riprodhohej një email i dalë drejt BELCERT-it, me pyetje mbi certifikatat A1808550 deri A1808554, ndërsa nuk jepej përgjigje e lëshuesit ose konstatim përfundimtar për pavlefshmëri, falsitet a fushë të papërshtatshme. As vendimi i 17.09.2026 nuk identifikon një përgjigje të BELCERT-it apo verifikim të plotë dokumentar. Një pyetje pa përgjigje nuk provon vetë mospërputhjen e ofertës.

6. Ankuesi ka pohuar se certifikatat ekzistojnë dhe mund të verifikoheshin te lëshuesi dhe përmes lidhjeve për verifikim. Të pesta mbajnë datën 01.07.2026, përpara afatit të dorëzimit 31.07.2026. Lëshimi në të njëjtën datë dhe mungesa e përgjigjes ndaj një emaili të Autoritetit Kontraktues nuk janë, vetvetiu, prova të pavlefshmërisë. AK duhej të administronte konfirmimin e numrave, lëshuesit, akreditimit/fushës së certifikimit dhe standardit të mbuluar, pa e trajtuar pohimin e operatorit si provë përfundimtare në mungesë të verifikimit.

7. Vendimi i ri thotë se të gjitha certifikatat janë “bazuar ekskluzivisht në vetëdeklarim” dhe nxjerr përfundimin se nuk ka pasur testim të pavarur laboratorik. Për këtë përfundim nuk identifikon raport laboratorik të kërkuar shprehimisht në FDT, procedurën e certifikimit të zbatuar nga lëshuesi apo përgjigjen e tij. Teksti i pikave 9.1/9.2, ashtu siç citohet nga vetë Autoriteti Kontraktues në vendim, kërkon që prodhuesi të jetë i certifikuar për standardet e numëruara, kopje të certifikatave dhe kusht për lëshuesin. Aty nuk paraqitet shprehimisht një kërkesë e veçantë për dorëzimin e raporteve laboratorike. Nëse AK e konsideron testimin të domosdoshëm sipas dosjes, duhet të tregojë kërkesën e shpallur dhe provat teknike për zbatimin e saj në këto dokumente.

8. Vendimi përmend mangësi konkrete lidhur me A1808553 dhe A1808554; për

A1808551 e A1808552 nuk kryen analizë të veçantë të standardeve, megjithëse përfundimi i përgjithshëm i përfshin të pesta këto certifikata. Për A1808553 AK vëren dallimin midis kodit TS EN 16955:2017 dhe titullit që sipas saj i përket EN 16139. Ankuesi kërkon të verifikohet me lëshuesin nëse kemi gabim në emërtim/kod, cilin standard mbulon realisht dokumenti i lëshuar më 01.07.2026 dhe nëse rezultati prek kërkesën materiale. Nuk kërkohet zëvendësim i një certifikimi të munguar me një certifikim të ri pas afatit.

9. Për A1808554 vendimi e quan kodin ‘UNI EN ISO 1600 9:2024’ të paqenë, ndërkohë që në citimin që vetë AK i bën kërkesës 9.1/9.2 shfaqet shënimi ‘UNI EN ISO 1600 9 2024’. Nëse këto citime pasqyrojnë saktë dokumentet origjinale, AK duhet të shpjegojë si e interpretoi kërkesën e saj, nëse ekziston gabim shkrimi në dosje ose në certifikatë dhe çfarë standardi konkret ishte kërkuar. Përputhshmëria nuk mund të vendoset me një konstatim të shkëputur nga formulimi i FDT-së dhe përgjigjja e lëshuesit.

10. Vlerësimi se dokumentet “mund të jenë fiktive apo jo reale” shprehet si mundësi, jo si gjetje e verifikuar. Autoriteti Kontraktues i referohet edhe nenit 99.2 të LPP-së, por pranon se nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejme për të verifikuar këto certifikata sipas nenit 72. Një dyshim për autenticitet kërkon provat dhe procedurën përkatëse dhe nuk është arsye për të zëvendësuar verifikimin me supozim në vlerësimin e përgjegjshmërisë. Autoriteti kontraktues ka pasur mundësi që të gjitha certifikatat ti verifikoj përmes linkut <https://en.belcert.com> ku të gjitha certifikatat e lëshuara mund të autentifikohen.

11. Neni 59.2 i LPP-së lejon sqarim me shkrim pa ndryshuar aspektet materiale të ofertës, ndërsa neni 72 lejon plotësimin ose qartësimin e certifikatave të përcaktuara në nenet 65–71. Nenet 38.3–38.5 dhe 38.8 të Rregullores përfshijnë qartësimin e certifikatave të paqarta, dokumente që pasqyrojnë objektivisht gjendjen para afatit dhe komunikimin në platformë përmes kërkesës për sqarim. Kur Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarim te BELCERT-i dhe megjithatë ka mbetur me dyshime të papërfunduara, duhej ta përdorte edhe procedurën e rregullt të sqarimit me operatorin. Vetëm se BELCERT nuk i ka kthyer ndonjë përgjigje Autoritetit Kontraktues nuk i bën certifikatat e pavlefshme dhe as operatorin ekonomik të përgjegjshëm.

12. Ankuesit nuk i është dërguar, sipas dokumenteve të paraqitura në këtë shqyrtim, kërkesë për sqarimin e ofertës në platformë për të sqaruar numrat, kuptimin e kodeve, titujt dhe bazën e certifikimit. Nëse verifikimi vërteton se mungon një kusht material, AK mund ta refuzojë ofertën me vendim të arsyetuar, pikërisht kjo çështje faktike ka mbetur e pazgjidhur.

13. Njoftimi i kontestuar e anulon procedurën me arsyetimin se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme, ndërsa vendimi i 17.09.2026 i referohet nenit 62.1 të LPP-së. Neni 43.5(b) i Rregullores lidhet me rastin kur asnjëri tender nuk është i përgjegjshëm. Meqë eliminimi i ankuesit është ende i paindividualizuar dhe verifikimi i certifikatave i papërfunduar, premisa faktike mbi të cilën AK ka mbështetur anulimin nuk është vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme. Arsytet e eliminimit të ofertuesve të tjerë nuk e zëvendësojnë vlerësimin e ofertës së ankuesit.

Prandaj duke marrë parasysh arsyet e sipërcekura, ankuesi kërkon që OSHP të:

- I. Aprovojë ankesën si të bazuar;
- II. Anulojë vendimin e 17.09.2026 që refuzoi rishqyrtimindhe ta anulojë eliminimin e ankuesit me B42 dhe vendimin B58 të 10.09.2026 për anulimin e procedurës, në pjesën që mbështetet në eliminimin e tij;
- III. Kthejë aktivitetin ELL-26-5915-1-2-1 në rivlerësim; dhe
- IV. Urdhërojë Autoritetin Kontraktues të bëjë krahasim të dokumentuar me FDT-në, t'i sqarojë certifikatat në mënyrën e lejuar nga nenet 59 dhe 72 të LPP-së e neni 38 i Rregullores, duke siguruar sipas nevojës konfirmim autentik nga BELCERT-i, dhe të nxjerrë vendim të ri të arsyetuar sipas rezultatit të rivlerësimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N/a

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.